

SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2021.

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike BigAlb Group sh.p.k.

Njesia ekonomike BigAlb Group sh.p.k e krijuar me date 23.03.2011 ushtron aktivitetin e saj ne fushen Supermarketeve dhe Administrimin e Aktivitetit te Rrjetit Big Market , Fashti Gropaj, Godina Tirana Cash & Carry, Vaqarr, Tirane .

Per periudhen 01 Janar 2021 deri me 31 Dhjetor 2021 jane pergatitur dhe paraqitur paketa e plote e pasqyrave financiare, te cilat japin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte pergjegjesi e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit(KKK). Gjuha e perdorur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdorur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithe periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitja e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjetër kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo trasaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.

Paraqitja e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e plote te standardeve te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **1,369,302,738 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;

⚡ Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **1,033,948,057 leke** te cilat jane te perbera nga;

1.Aktive monetare 218,714,193 leke. Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 *Efektet e ndryshimeve te kurseve te kembimit* dhe paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen lek dhe euro ne date 31.12.2021. Kursi i kembimit eshte perdorur ne menyre sistematike gjate gjithe ushtrimit te aktivitetit te subjektit per ngjarjet e trasaksionet te cilat jane kryer ne monedha te huaja.

2.Investime jane paraqitur ne vleren **312,707,001 leke.** Kjo vlere perbehet nga te gjitha kapitalet qe subjekti Big Alb Group shpk ka derdhur per shoqerite e reja Big Market qe jane hapur gjate vitit 2021 ku eshte aksionere.



2. Te drejta te arketueshme te cilat jane paraqitur ne vleren **483,309,758 leke** dhe eshte e perbere nga;

Zeri, Nga aktiviteti i shfrytëzimit ne vleren **207,604,333 leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilen përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, te paraqitura me vleren neto te realizueshme.

Zeri, Te Tjera ne vleren **245,988,467 leke** , i cili eshte i perbere nga

-Huat Afatshkurtar qe Big Alb Group i ka dhene shoqerive Big Market, apo paleve te treta ne vleren **245,988,467 leke**.

Zeri, Kerkesa ndaj tatim taksave ne vleren **29,716,959 leke**, përfshihen të gjitha të drejtat e njësisë ndaj të tretëve, te krijuar gjate periudhes ushtrimore i cili eshte i perbera prej;

Tatim fitimi	444	3,042,197 leke
Tvsh	4453	26,674,762 leke

3. Inventari i paraqitur ne vleren **17,356,106 leke**, i cili eshte i perbere prej;

Zeri Mallra ne vleren 17,356,106 leke, **mallra per rishitje** jane njohur dhe vleresuar ne perputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit eshte vleresuar me metoden e kosos mesatare te ponderuar.

4. Shpenzime te shtyra, ne vleren **1,860,999 leke**.

✦ Informacione shpjeguese te **AKTIVET AFATGJATA**

Aktivët afatgjata jane paraqitur ne Vleren Kontabel Neto **335,354,681 leke**. Ato jane evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 5 Aktivët afatgjata materiale dhe aktivët afatgjata jomateriale. Paraqitja e tyre eshte bere nepermjet politikës kontabel Metoda e Kosos. Perberja e ketij zeri paraqitet si vijon;

1. Aktive afatgjata materiale jane ne vleren **335,354,681 leke** dhe eshte i perbere nga zeri

Toka dhe Ndertesa ne vleren **288,866,124 leke**. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren 8,625,825 leke.

Pajisje Kompjuterike ne vleren **3,510,295 leke**. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren 996,800 leke.

Të tjera Instalime dhe pajisje ne vleren **41,958,912 leke**. Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur dhe eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren 6,541,132 leke



Ne te jane te perfshire elementet e meposhtem;

Nr. Llogarie	Emertimi i Llogarise	Monedha	Debi	Kredi
2181	<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	LEK	66,042,128	
2182	<i>Pajisje Kompjuterike,</i>	LEK	6,652,343	
2122	<i>Ndertesa</i>	LEK	311,944,922	
281801	<i>Per Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	LEK		24,083,216
281802	<i>Per Pajisje Kompjuterike, Pajisje Zyre</i>	LEK		3,142,048
281803	<i>Per Ndertesa</i>	LEK		23,078,799

Parapagime per aktive materiale dhe ne proces ne vleren **1,019,351 leke** paraqet të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj furnitoreve te aktiveve materiale per parapagimet e dhena.

II. Informacione Shpjeguese per DETYRIMET.

Detyrimet e paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **387,384,424 leke** dhe perbehet vetem nga detyrime te periudhave afashkurtra. Detajimi jepet nepermjet informacioneve shpjeguese si vijon;

↓ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra jane paraqitur ne total ne vleren **386,888,443 leke**, dhe jane te perbera nga detyrimet ndaj furnitoreve, punonjesve , detyrime ndaj shtetit per tatime dhe taksa.

- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **381,426,906 leke** paraqesin detyrimin e papaguar per blerjen e mallrave nga furnitore te ndryshem te njesise ekonomike ne fund te vitit 2021.

- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore ne vleren **18,874,224leke** perbejne vetem detyrimin per pagat e personelit te papaguara deri ne fund te vitit 2021 si dhe detyrimin per sigurimet shoqerore dhe shendetsore per muajin Dhjetor 2021, i cili detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Sigurime Shoqerore	431+442	1,508,874
Ndaj punonjesve	421	365,350

- Të pagueshme për detyrimet tatimore ne vleren **3,023,060 leke** paraqesin detyrimet e papaguara deri ne fund te vitit 2021 per tatimin ne burim.

-Te pagueshme per shpenzime te konstatuara **181,140** paraqesin shpenzime te periudhave te ardhshme

-Te ardhura te shtyra **383,113**



Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATGJATA

Detyrimet Afatgjata jane paraqitur ne total ne vleren **495,980 leke**, dhe jane te perbera nga

- Fonde nga punonjesit Big Market per fatkesqine natyrore **495'980 leke**

II. Informacione Shpjeguese per KAPITALIN

Kapitali i paraqitur ne vleren 981,918,314 leke dhe eshte i perbere nga zerat Kapital i nenshkruar, Fitime te Pashperndara dhe Fitim / Humbje e vitit, detajimi i te cilave do te jepet ne informacionet shpjeguese.

1. Informacione shpjeguese te zerit KAPITAL

Ne kete ze jane paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe jane përmbledhur tepricat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali i paguar,	101	105'800'000
Totali		105'800'000 leke

2. Informacione shpjeguese te zerit REZERVA TE TJERA

1- Rezerva Ligjore ne vleren **661'600 lek**

2- Rezerva te tjera ne vleren **59'697 lek**

3. Informacione shpjeguese te zerit FITIME NGA FILIALET

Zeri *Fitime nga Filialet* paraqitet ne vleren **262,952,678 leke** dhe perfshin fitimet qe njesite ekonomike ku Big Alb Group Shpk eshte ortak i kane derdhur kesaj te fundit ne baze te vendimeve te asamblese te seciles "shoqeri bije".

4. Informacione shpjeguese te zerit FITIM I PASHPERNDARE

Zeri *Fitim i pashperndare* paraqitet ne vleren **619,597,538 leke**. Ne te paraqitet rezultati i njesise dhe Fitimet e arketuara nga Filialet, te pashperndara nga periudhat paraardhese.

5. Informacione shpjeguese te zerit FITIM / HUMBJE E VITIT

Zeri *Fitim / Humbje e vitit* paraqitet ne vleren **-7,153,198 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.



❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.**

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar nje humbje ne vleren **-7,153,198 leke**.

Zeri Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit te paraqitura ne pasqyre evidenton te gjitha shitjet dhe Sherbimet e realizuara me vleren e tyre neto **549,549,181leke**.

Zeri Të ardhura të tjera të shfrytëzimit të paraqitura në pasqyrë evidenton të gjitha të ardhurat e tjera nga kurset e këmbimit, kontratat e bashkëpunimit me të tretët dhe arkëtim dëmi (polic sigurimi), me vlerën e totale neto **1,870,393 lekë**.

Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme te paraqitura ne vleren **454,637,145 leke** perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje. Politika kontabel eshte paraqitur me larte ne zerin *Mallra per shitje* (Inventar).

Zeri Shpenzime të personelit i cili eshte i paraqitur ne vleren **52,321,959 leke** perfaqeson:

1. **Shuma Paga dhe shpërblime** gjate periudhes ushtrimore 01.01.2021- 31.12.2021 ne vleren **45,618,531 leke**
2. **Shuma Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)** gjate periudhes ushtrimore 01.01.2021-31.12.2021 ne vleren **6,703,428 leke**.

Zeri Shpenzime Konsumi dhe amortizimi te cilat jane te paraqitura ne vleren **16,163,758 leke** .

Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi te cilat jane te paraqitura ne **vleren 35,143,264 leke** perfaqesojne shpenzimet te cilat jane kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesise ekonomike, dhe perfaqeson zera te shpenzimeve si furnitura, taksa te ndryshme dhe te tjera.

Zeri Shpenzime të tjera financiare te cilat jane te paraqitura ne vleren **306,646 leke**, perfaqesojne shpenzimet per komisionet e bankare , si dhe interesat per Huan .

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare jane paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësinë ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja eshte bere sipas metodes indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **31,921,613 leke**. Fluksi negativ ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga, detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave jane me te larta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike dhe investimeve ne filialet e reja.



Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren **122,264,430 leke**. Fluksi pozitiv ka ardhur si pasoje Fitimeve nga Filialet.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT .**

Ndryshimet ne zerin Kapital kane ardhur si rezultat;

1. Fitim / Humbje e vitit ne vleren **(7,153,198) leke**.
2. Fitimi nga Filialet ne vleren **262.952,678 leke**

Informacionet shpjeguese per zerat e mesiperm jane dhene ne pasqyren e Bilancit.

Drejtuesi

Elona Kosha



Hartues

Jonida Kumaraku

